

# Njoftim per konsultim publik – ProEnergy L.L.C

## Ftesë - Konsultimi i Grupeve Lokale të Interesit për aktivitetin e projektit të karbonit për Standardin e Artë “Projekti Fotovoltaik 3MW në Kosovë nga Pro Energy LLC”

Ky njoftim publik i referohet projektit të energjisë diellore prej 3MW me titull “Projekti Fotovoltaik 3MW në Kosovë nga Pro Energy LLC” i cili gjendet në fshatin Grackë e Vjetër në Komunën e Lipjanit. Ky projekt do të zvogëlojë emetimet e gazrave serrë në atmosferë dhe në këtë mënyrë do të kontribuojë në përpjekjet e përgjithshme për të luftuar ngrohjen globale.

Sipas kërkesave të Mekanizmit të Standardit të Artë, Pro Energy LLC planifikon të organizojë një takim konsultativ me grupet lokale të interesit për të kuptuar opinionin/shqetësimet dhe për të marrë një reagim të përgjithshëm në lidhje me aktivitetin e projektit. Takimi mbahet në kuadër të procedurave të Standardit të Artë Për Qëllimet Globale-GS4GG për projektet e Standardit të Artë-Zvogëlimi Vullnetar i Emetimeve GS-VER dhe synon t'ua shpjegojë projektin grupeve të interesit dhe të diskutojë mbi ndikimin e aktivitetit të projektit në mjedis dhe në zhvillim të qëndrueshëm.

Ky konsultim publik mbahet për të gjitha grupet lokale të interesuara apo të prekura nga projekti, duke përfshirë organizatat jo-qeveritare, grupet e grave, institutet kërkimore dhe organizatat/individët që punojnë në tema që ndërlidhen me aktivitetin e projektit, hartuesit e politikave në nivel qendror dhe lokal, si dhe për komunitetin lokal, komunitetet dhe/ose përfaqësuesit që preken drejtpërdrejt ose tërthorazi nga projekti. Prandaj, konsultimi me palët lokale të interesit do të ndihmojë në rritjen e kontributit të projektit në zhvillimin e qëndrueshëm.

Informatat në lidhje me këtë takim janë si në vijim:

Data: 28/12/2021

Koha: 10:00 deri në 13:00

Vendi: Salla e Asamblese se Kuvendit Komunal te Lipjanit

Rendi i ditës së këtij takimi është:

- a) Hapja e takimit
- b) Shpjegimi i projektit në terma jo teknikë
- c) Sesion me pyetje dhe përgjigje rreth projektit
- d) Diskutimi për rreziqet e mundshme të projektit (ndikimet negative)
- e) Më pas, diskutimi për rreziqet pasohet me diskutimin për ndikimet pozitive
- f) Diskutimi i planit të monitorimit për ndikimet e zhvillimit të qëndrueshëm
- g) Diskutimi i mekanizmit për kontribut dhe ankesa
- h) Mbyllja e takimit

Ju lutemi, ta keni parasysh se pjesëmarrja juaj do të jetë e rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të programit. Nëse nuk keni mundësi të merrni pjesë por dëshironi të merrni informata dhe të shprehni shqetësimet dhe opinionet tuaja, këtë mund ta bëni duke kontaktuar personalisht ose përmes e-mailit apo telefonit:

Sinqerisht i juaji,

Për Pro Energy LLC

Z. Fatos Hasani, Drejtor

Adresa: Xhorxh Bush Nr. 26, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës

Tel.:

E-maili: [Fatos.Hasani@procredit-group.com](mailto:Fatos.Hasani@procredit-group.com)